



Prishtinë, 14 tetor 2016  
Kodi i ZRRE-së: V\_849\_2016

Bordi i Zyrës së Rregulatorit për Energi,

Bazuar në:

- Dispozitat e nenit 26 paragrafi 1, nenit 47 dhe nenit 48 të Ligjit pë Rregulatorin e Energjisë Nr. 05/L-084;
- Dispozitat e nenit 19 të Ligjit pë Energjinë Nr. 05/L-081;
- Dispozitat e nenit 18 dhe nenit 19 të Ligjit pë Energjinë Termike Nr. 05/L-052;
- Rregullën për Vendosjen e Çmimeve të Energjisë Termike; dhe
- Shkresën e Ndërmarrjes Publike – Ngrohtorja e Qytetit (NQ) Gjakova sh.a. të datës 3 tetor 2016.

Pas shqyrtimit të shkresës dhe bazuar në dispozitat ligjore të cekura më lartë, në seancën e mbajtur me datë 14 tetor 2016, nxori këtë:

## VENDIM

- I. APROVOHEN tarifat e energjisë termike, të njëjtë si në sezonin e kaluar, për konsumatorët fundorë të Ngrohtores së Qytetit (NQ) Gjakova sh.a. për sezonin e ngrohjes 2016/2017, siç janë paraqitur në tabelën ‘II.1’, që do të zbatohen nga data 15 tetor 2016.

### Arsyetim

1. Me datën 3 tetor 2016, Zyra e Rregulatorit për Energji (ZRRE) ka pranuar shkresën nga Ngrohtorja e Qytetit (NQ) Gjakova SH. A, me anë të së cilës ZRRE njoftohet për arsyet që pamundësojnë një aplikim të kompletuar dhe të bazuar në parashikime reale, për shqyrtimin e tarifave të energjisë termike për sezonin. Arsyet e cekura në shkresë përmblidhen në vijim:
  - NQ Gjakova, edhe në këtë sezon, për prodhimin e energjisë termike do të bazohet në lëndën djegëse mazut, që paraqet një kosto të papërballueshme financiare për ndërmarrjen;
  - Duke marrë parasysh këtë dhe gjendjen aktuale të vështirë financiare, operimi i NQ Gjakova do të jetë në masë të madhe i varur nga subvencionet prej Buxhetit të Kosovës – për vitin kalendarik 2016 janë siguruar subvencionet ndërsa shpresohet se do të sigurohet një shumë e mjaftueshme edhe për vitin 2017.
  - NQ Gjakova është përfituese e projekteve në vlerë prej 12 milion Euro të financuar nga BE për ndërtimin e ngrohtores së re me biomasë, që është në fazën përgatitore; realizimi i këtij projekti do mundësoj që në të ardhmen të ofrohet furnizim i pandërprerë dhe kualitativ. Sidoqoftë deri në realizimin e tij NQ Gjakova do përpinqet të mbajë vazhdimësinë e operimit dhe të ofroj furnizim brenda mundësive të limituara financiare, ashtu që gradualisht të rikthej besimin e konsumatorëve.
  - Shkaqet e theksuara më lartë vështirësojnë çdo planifikim (parashikim) real dhe mjaftueshëm të saktë për një shqyrtim të mirëfilltë tarifor.



2. Bordi i ZRRE ka marr parasysh arsyetimet e paraqitura në shkresën e NQ Gjakova, të cilat i ka konsideruar të drejta dhe të argumentuara.
  3. Duke marr parasysh dispozitat ligjore të theksuara në hyrje dhe duke u bazuar në shqyrtimin e shkresës së NQ Gjakova të datës 3 tetor 2016, Bordi i ZRRE-së ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- II. Struktura e tarifave të energjisë termike për NQ Gjakova sh.a. për sezonin e ngrohjes 2016/2017 është dhënë në tabelën II.1 më poshtë.

**Tabela II.1: Struktura e tarifave të energjisë termike për NQ Gjakova sh.a. – sezioni 2016/2017**



TARIFAT E ENERGISË TERMIKE TË NQ GJAKOVA - Sezioni 2016/2017		
A: TARIFAT E ENERGISË TERMIKE ME MATJE		
Komponentët e tarifës	Njësia	Vlera
Tarifa Mujore për Kapacitetin Termik (Komp. fikse)	[€/kW/muaj]	0.91
Tarifa për Furnizim /Konsum të En. Term. (Komp. variabile)	[€/MWh]	58.76
B: TARIFAT E ENERGISË TERMIKE PA MATJE		
Komponentët e tarifës	Njësia	Konsumat. shtëpijak
Tarifa mujore për Kapacitetin Termik (komponenta fikse)	[€/m <sup>2</sup> për muaj]	0.09
Tarifa për Furnizimin /Konsumin e En. Term. (komp. variabile)	[€/m <sup>2</sup> për muaj]	0.88
		1.27

- III. NQ Gjakova sh.a. duhet ta publikoj strukturën e tarifave të energjisë termike siç është përcaktuar në tabelën II.1 të këtij Vendimi, brenda pesë (5) ditëve të punës pas shpalljes dhe publikimit të këtij vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, në së paku një prej gazetave ditore me qarkullim më të gjerë në Kosovë.
- IV. Zyra e Regulatorit për Energji (ZRRE) ka të drejtë, që të auditojë registrat e kontabilitetit dhe faturat e NQ Gjakova, për të verifikuar realizimin e të hyrave dhe kostove të realizuara në sezonin 2016/2017.
- V. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
- VI. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të zbatohet nga NQ Gjakova nga data 15 tetor 2016 gjer në shqyrtimin e ardhshëm tarifor.
- VII. Ky Vendim publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.




**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve, nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

  
Krenar Bujupi, u.d. kryesues  
  
Arsim Janova, anëtar

Qemajl Mustafa, anëtar

  
Besim Seffijai, anëtar

Vendimi ju dërgohet:

- Palës; dhe
- Arkivit të ZRRE-së